



Republika e Kosovës
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit



DEKADA E SIGURISË RRUGORE 2010-2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Koordinues i Këshillit për Sigurinë në rrugë

Hyrje

Në Republikën e Kosovës që nga periudha e pasluftës kemi pasur rritje të vazhdueshme të numrit të automjeteve të cilat janë në përdorim. Krahas kësaj rritje është rritur edhe numri i aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe si pasojë siguria rrugore është bërë njëri nga problemet kryesore për shëndetin publik të shoqërisë.

Meqë aksidentet në komunikacionin rrugor paraqesin një problem të natyrës multidisciplinare, atëherë edhe përballja me këtë problem kërkon angazhimin e të gjithëve, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të kemi sukses në uljen e numrit të aksidenteve dhe rrjedhimisht edhe uljen e numrit të të vdekurve.


Secili prej nesh në një formë apo në një tjetër jemi pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, andaj secili prej nesh si individ apo si organizatë, është përgjegjës për sigurinë e vet dhe sigurinë e të tjerëve në komunikacionin rrugor.

Duke u sjellë në pajtim me ligjet dhe rregullat e komunikacionit rrugor, secili mund të jap kontributin që i takon në dobi të përmirësimit të sigurisë në komunikacionin rrugor.

Të punojmë të gjithë së bashku për të shpëtuar jetën e qytetarëve tanë!

Numri i përgjithshëm i aksidenteve gjatë dekadës 2010 – 2019

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
NR.	18030	18888	19754	19954	16300	17722	18541	17695	15741	16199




Në këtë tabelë vërehet se numri më i madh i aksidenteve të përgjithshme gjatë dekadës së fundit ka qenë në vitin 2013 me gjithsej **19954** aksidente, ndër vite kemi numër më të vogël të aksidenteve ku në vitin 2018 kemi **15741**, shprehur në përqindje kemi **21.11 %** aksidente më pak.

FAKTORI NJERI ME 85 % PJESËMARRJE NË AKSIDENTE

**Numri i përgjithshëm i aksidenteve me lëndime gjatë dekadës
2010 - 2019**

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
NR.	4326	4490	4555	4960	4876	5275	6130	6390	6217	6140




Në këtë tabelë vërehet se numri më i vogël i aksidenteve me lëndime gjatë dekadës së fundit ka qenë në vitin 2010 me gjithsej 4326 aksidente, ndër vite janë në rritje ku numër më të madh të aksidenteve me lëndime kemi në vitin 2017 kemi 6390, shprehur në përqindje kemi 32.30 % aksidente më shumë.

**“QYTETARËT JANË VETËDIJËSUAR PËR T’I KURUAR
LËNDIMET TRUPORE NGA AKSIDENTET”.**

Numri i përgjithshëm i aksidenteve me dëme materiale gjatë dekadës 2010 - 2019

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
NR.	12594	13338	14044	13878	10333	11145	12312	11183	9424	9959




Në këtë tabelë vërehet se numri më i vogël i aksidenteve me dëme materiale gjatë dekadës së fundit ka qenë në vitin 2018 me gjithsej 9424 aksidente, ndër vite numri i aksidenteve është në zvogëlim, ku numër më të madh të aksidenteve me dëme materiale është në vitin 2012 kemi 14044, shprehur në përqindje kemi 32.89 % aksidente më pak.

**“JETA E NJERIUT NUK ËSHTË PJESË E MAKINËS, SHIJOJE
JETËN PA AKSIDENTE”**

Numri i përgjithshëm i aksidenteve fatale gjatë dekadës 2010 - 2019

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
NR.	158	130	116	104	111	117	99	122	100	100




Në këtë tabelë vërehet se numri më i vogël i aksidenteve fatale gjatë dekadës së fundit ka qenë në vitin 2016 me gjithsej 99 aksidente, ku numër më të madh të aksidenteve fatale është në vitin 2010 kemi 158, shprehur në përqindje nga viti 2010 aksidentet fatale janë në zvoglim për 37.34 %.

“JETA NUK KA ÇMIM”

Numri i përgjithshëm i personave të vdekur gjatë dekadës 2010 – 2019

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
NR.	175	157	121	119	127	129	110	137	129	113



Në këtë tabelë vërehet se numri më i vogël i aksidenteve me persona të vdekur gjatë dekadës së fundit ka qenë në vitin 2016 me gjithsej 110 persona të vdekur, ku numër më të madh të aksidenteve me persona të vdekur është në vitin 2010 kemi 175, shprehur në përqindje nga viti 2010 aksidente fatale janë në zvogëlim për 37.14 %.

Vdekjet në nivel global nga aksidentet në trafik

Numri i vdekjeve në rrugët në botë mbetet i lartë në mënyrë të papranueshme, me rreth 1.35 milion njerëz që vdesin çdo vit.


Numri i vdekjeve në trafikun rrugor vazhdon të rritet vazhdimisht, duke arritur në 1.35 milion në vitin 2016. Sidoqoftë, shkalla e vdekjes në krahasim me madhësinë e popullsisë në botë ka mbetur konstante. Kur konsiderohet në kontekstin e rritjes së popullsisë globale dhe motorizimit të shpejtë që ka ndodhur gjatë së njëjtës periudhë, kjo sugjeron që përpjekjet ekzistuese për sigurinë rrugore mund të kenë zbutur situatën nga përkeqësimi.

Në dekadën e fundit në Kosovë kanë humbur jetën 1306 njerëz, që i bie diku rreth 130.6 njerëz në vit.

Kurse viti me më pak aksidente me vdekje është viti 2016 me 110 vdekje në aksidente të trafikut rrugor, kurse viti më me shumë aksidente me vdekje është viti 2010 me 175 vdekje në rrugët e vendit tonë, shprehur në përqindje aksidente me persona të vdekur janë në zvogëlim për 37.14 %.

Numri i personave të vdekur nga aksidentet e trafikut rrugor për 1,000,000 banorë sipas viteve për periudhën kohore 2010-2019

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Persona të vdekur	175	157	121	119	127	129	110	137	129	113
Për 1,000,000 banorë	101	91	69	68	73	74	63	78	74	65




Nuk ka njëtrajtshmëri sa i përket zvogëlimit të aksidenteve në nivel global.

Një numër i vendeve kanë pasur sukses në zvogëlimin e vdekjeve në trafikun rrugor gjatë viteve të fundit, por progresi ndryshon dukshëm midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme të botës. Vazhdon të ketë lidhje të fortë midis rrezikut të vdekjes në trafikun rrugor dhe nivelit të të ardhurave të vendeve. Me shkallë mesatare prej 27.5 vdekje për 100,000 banorë, rreziku i vdekjes në trafik rrugor është më shumë se tre herë më i lartë në vendet me të ardhura të ulëta se sa në vendet me të ardhura të larta, ku shkalla mesatare është 8.3 vdekje për 100,000 banorë.

Sa i përket vendit tonë shkalla e vdekjeve nga aksidentet rrugore në 100,000 banorë është 6.3 njerëz të vdekur si bazë është marr viti i fundit 2019.


Këmbësor të vdekur sipas viteve 2010-2019

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
NR.	60	45	42	33	39	48	25	43	31	40






Këmbësor të lënduar 2010-2019




Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
NR.	1053	1027	1029	1242	1216	1176	1258	1322	1225	1093



Të vdekur sipas grupmoshave (0-12 vjeç , 13-18 vjeç dhe mbi 19 vjeç)




Të lënduar sipas grupmoshave (0-12 vjeç , 13-18 vjeç dhe mbi 19 vjeç)



Aksidentet e përgjithshme gjatë javës, gjatë viteve 2010-2019


	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
E hënë	2879	2996	3238	3269	2501	2849	3031	2696	2521	2605
E martë	2701	2875	2799	3058	2466	2615	2730	2607	2279	2374
E mërkure	2703	2642	2834	2959	2456	2596	2682	2662	2233	2404
E enjte	2515	2712	3002	2735	2360	2615	2705	2570	2301	2320
E premte	2672	2804	3029	2925	2481	2630	2832	2665	2465	2460
E shtune	2719	2779	2770	2909	2242	2394	2564	2496	2141	2232
E diel	1824	2084	2082	2073	1794	2023	1997	1999	1801	1804

Aksidentet e përgjithshme sipas diteve të javës 2010-2019




Aksidentet e përgjithshme gjatë 24 orëve të ditës gjatë viteve 2010-2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
22:00-02.00	1188	1178	1268	1286	1037	1206	1346	1438	1178	1287
02.00-06.00	411	390	471	525	440	619	616	598	452	479
06.00-10.00	2533	2626	2683	2767	2166	2411	2610	2340	2054	1970
10.00-14.00	4999	5326	5541	5637	4540	4833	4960	4635	4046	4125
14.00-18.00	5473	5820	6149	6230	5172	5476	5604	5386	5031	5140
18.00-22.00	3395	3552	3643	3483	2945	3177	3405	3296	2980	3198



Aksidentet sias rajoneve dhe autostradës për vitet 2010-2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Autostradë¹	0	0	0	71	233	365	402	457	478	565
Prishtinë	8056	8342	8691	9596	7437	8157	8160	7604	6493	6824
Gjilan	1588	1576	1589	1536	1281	1380	1413	1384	1256	1237
Ferizaj	1463	1545	1699	1551	1373	1565	1750	1769	1419	1355
Prizren	2600	3183	3221	2854	2263	1662	2062	1941	1974	1924
Gjakovë²	0	0	0	0	0	1194	1083	1062	974	1098
Pejë	2850	2750	2957	2574	2220	1793	1940	1847	1673	1774
Mitrovicë - Jug	1474	1492	1597	1680	1315	1440	1562	1476	1313	1283
Mitrovicë-Veri³	0	0	0	0	179	166	169	155	161	139




¹ Autostrada si Njësi Policore ka filluar se funksionuari në fund të vitit 2012 andaj të dhënat statistikore kanë filluar të regjistrohen nga viti 2013,

² DRP- Gjakovë është formuar si rajon policor nga vitit 2015, andaj të dhënat deri në vitin 2014 janë të pasqyruara në DRP-Pejë,

³ DRP- Mitrovicë Veri është formuar si rajon policor nga vitit 2014, andaj të dhënat deri në vitin 2013 janë të pasqyruara në Mitrovicë Jugu.

Aksidentet sipas llojit të rrugës për vitet 2010-2019


	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Magjistrale	4726	4217	4639	4886	3932	4406	4357	4060	3736	3767
Rajonale	1492	1204	1406	1491	1321	1328	1323	1330	1326	1295
Urbane	9788	10661	11392	11147	9201	9936	10504	10008	8627	9079
Rurale	1751	1831	2012	2073	1279	1625	1892	1927	1739	1695
Autostradë⁴	0	0	0	71	248	167	176	187	220	235
Të tjera	236	977	305	329	319	260	289	183	93	128



⁴ Autostrada si Njësi Policore ka filluar se funksionuari në fund të vitit 2012 andaj të dhënat statistikore kanë filluar të regjistrohen nga viti 2013.


Aksidentet fatale sipas rajoneve gjatë viteve 2010-2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Autostradë	0	0	0	2	3	7	7	13	5	7
Prishtinë	48	39	31	35	34	31	33	31	34	36
Gjilan	15	12	19	10	10	12	3	10	8	17
Ferizaj	19	13	14	10	12	9	12	16	9	7
Prizren	28	27	23	12	17	10	5	7	8	9
Gjakovë	0	0	0	0	0	11	11	11	11	8
Pejë	33	23	18	26	22	18	16	18	15	11
Mitrovicë - Jug	15	16	11	6	7	14	8	14	9	4
Mitrovicë - Veri	0	0	0	3	6	5	4	2	1	1



Persona të vdekur sipas rajoneve gjatë viteve 2010-2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Autostradë	0	0	0	2	6	7	7	14	6	8
Prishtinë	54	43	32	40	37	35	38	35	43	38
Gjilan	16	13	19	10	12	14	4	11	9	18
Ferizaj	21	13	16	10	12	9	12	19	14	7
Prizren	31	30	24	12	17	12	5	8	13	13
Gjakovë	0	0	0	0	0	11	15	14	11	13
Pejë	36	38	19	33	25	22	17	20	23	11
Mitrovicë - Jug	17	20	11	6	8	14	8	14	9	4
Mitrovicë - Veri	0	0	0	6	10	5	4	2	1	1



AKTIVITETET KRYESORE PËR SIGURI NË TRAFIKUN RRUGOR (2018&2019)

Aktivitetet e realizuara me qëllim të sensibilizimit për siguri rrugore përmes spoteve televizive, broshurave dhe ligjërimeve nëpër shkolla, të gjitha janë organizuar në bashkëpunim me institucionet vendore (qendrore/lokale), mekanizmat ndërkombëtar, organizata jo-qeveritare dhe mediat.

Fushatat vetëdijësuese për vitin 2018



PËR NJË VIT MË TË SIGURT NË TRAFIK

Shpejtësia brenda zonës urbane

Gjohat	€	Pikë negative	Ndalim i drejtimit
Mbi 50 km/h	300 - 900	5	1 vit
Prej 30-50 km/h	300 - 900	3	6-12 muaj

Shpejtësia jashtë zonës urbane

Gjohat	€	Pikë negative	Ndalim i drejtimit
Mbi 50 km/h	200 - 600	3	3 muaj
Prej 30-50 km/h	100 - 300	2	-

Përdorimi i telefonit: 40 €

Mos vendosja e rripit të sigurisë: 40 €

Telefoni: 192

www.kosovopolic.com
facebook.com/kosovopolicimp
info@kosovopolic.com

137

TË VDEKUR NË VITIN 2017 NË AKSIDENTE TRAFIKU

SHFRYTËZUESIT E RRUGËS

SHOFER - 42	44	6	6
1 SHOFER MË PAK SE NË VITIN 2016	19 KËMBËSORË MË SHUMË SE NË VITIN 2016	5 DËCIKLISTË MË SHUMË SE NË VITIN 2016	3 MOTOCIKLISTË MË SHUMË SE NË VITIN 2016
PASAGJER - 39	26	E DIEL	
1 PASAGJER MË SHUMË SE NË VITIN 2016	15 FEMË MË SHUMË SE NË VITIN 2016	NË DITËN E DIEL KANË NDODHUR MË SE SHUMTI AKSIDENTE FATALE (23 AKSIDENTE MË FATALITET)	
		NË INTERVALIN KOHOR PREJ 14:00 - 18:00 KANË NDODHUR MË SE SHUMTI AKSIDENTE FATALE (33 AKSIDENTE MË FATALITET)	

Pabarazitë vazhdojnë nëpër rajone

Ndërsa shkalla globale e vdekjeve në trafikun rrugor është 18.2 për 100,000 banorë, ekziston një ndryshim i dukshëm në të gjithë rajonet e botës, ku shkalla e vdekjes varion nga 9.3 në 26.6 për 100,000 banorë. Shkalla rajonale e vdekjeve në trafikun rrugor në Afrikë dhe Azinë Jug-Lindore është më e larta, përkatësisht 26.6 dhe 20.7 vdekje për 100,000 njerëz. Kjo pasohet nga rajonet e Mesdheut Lindor dhe Paqësorit Perëndimor, të cilat kanë shkallë të krahasueshme me atë globale, përkatësisht 18 dhe 16.9 vdekje për 100,000 banorë. Amerika dhe Evropa kanë shkallën më të ulët rajonale, përkatësisht 15.6 dhe 9.3 vdekje për 100,000 banorë. Sa i përket progresit të bërë, në tri nga gjashtë rajonet (Amerika, Evropa, Paqësori Perëndimor), shkalla e vdekjes është ulur që nga viti 2013.

Shkalla e vdekjes në trafikun rrugor është më e larta në Afrikë (26.6/100,000 njerëz) dhe Azinë Jug-Lindore (20.7/100,000 njerëz).

Më shumë se gjysma e të gjitha vdekjeve në trafikun rrugor janë ndër përdoruesit më të cenuar të rrugëve si: këmbësorët, çiklistët dhe motoçiklistët.



Në Kosovë janë shqetësuese vdekjet e këmbësorëve në trafikun rrugor, ku diku në dekadën e fundit si pasojë e aksidenteve rrugore kanë humbur jetë 406 persona, që i bie brenda një viti kanë humbur jetë rreth 40.6 në cilësinë e këmbësorit.

Legjislacioni dhe sjellja e përdoruesve në rrugë

Miratimi dhe zbatimi i legjislacionit mbi faktorët kryesorë të rrezikut të sjelljes, përfshirë shpejtësinë, vozitjen nën ndikim të alkoolit dhe mospërdorimin e helmetave në motoçikletë, rripave të sigurimit dhe mjeteve kufizuese për fëmijë, janë përbërës thelbësor të një strategjie të integruar për të parandaluar vdekjet në trafikun rrugor.

Pengesa kryesore në vendin tonë është zbatimi i ligjit duke përfshirë respektimin e shpejtësisë, përdorimin e rripit të sigurisë, përdorimin e ulëseve për fëmijë, përdorimin e helmetës gjatë ngasjes së mjeteve me dy apo tri rrota pa kabinë mbrojtëse, mos përdorimin e telefonit, mos përdorimin e alkoolit etj.



**TË SIGURT
NË RRUGË
GJATË DIMRIT**

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
KOSOVA POLICE
AMCK
AUTOMOTIVE CLUB KOSOVA

PAJISJET DIMËRORE,
OBLIGIM LIGJOR PËR
PERIUdhËN:
15 NËNTOR DERI 15 MARS

**15/11
15/03**

Pajisjet dimërore për automjetet e udhëtarëve dhe mjeteve transportuese deri në 3.5t janë: pneumatikët e dimrit në të gjitha rrotat, ose pneumatikët verorë me thellësi minimale të sipërfaqes shkelëse prej 4 mm, me zinxhirët e borës që vendosen në rrota tërheqëse.

Pajisjet dimërore për autobus dhe mjeteve transportuese mbi 3.5ton, janë zinxhirët ose pneumatikët e dimrit të montuar në rrotat tërheqëse.

Autobusët dhe mjetet e transportit mbi 3.5t, që nuk mund të vendosin zinxhirët e borës në rrota tërheqëse duhet të kenë pneumatikët e dimrit në rrota tërheqëse.

Pneumatikët e dimrit janë të shënuar me shenjë M+S, MS, M&S, ose ndonjë shenjë tjetër identifikuese nga prodhuesi i pneumatikëve.

Shoferët të cilët drejtojnë mjetet e tyre pa pajisje dimërore do të dënohen për kundërvajtje me gjobë prej dyzet (40) eurosh.

Shoferët në cilësi të personave juridik ose institucioni publik në emër të cilit dhe brenda autorizimeve të cilit ka vepruar personi i përcaktuar dënohet për kundërvajtje me gjobë njëqind e pesëdhjetë (150) euro.



Shenja e rrezikut (për sezonin dimëror)



TELEFONO: 192

www.mi-ks.net
www.kosovapoliice.com
www.amck.eu

Rrugët e sigurta

Infrastruktura rrugore është e lidhur fort me shkaktimin e lëndimeve fatale dhe serioze në përplasjet në trafikun rrugor dhe hulumtimet kanë treguar që përmirësimet në infrastrukturën rrugore, veçanërisht standardet e projektimit që marrin parasysh sigurinë e të gjithë përdoruesve në rrugë, janë thelbësore për sigurimin e rrugëve.

Fushatat vetëdijësuese për vitin 2019



Dedikuar

Shofer

Shiko!

- Prite këmbësorin!
- Bëj kujdes!
- Mos shkruaj përdërisa je duke drejtuar automjetin!
- Respekto shpejtësinë e kufizuar!

Këmbësor

Bëhu i dukshëm!

- Përdor vendkalimin e këmbësorëve!
- Respekto semaforin!
- Shiko majtas, shiko djathtas, shiko majtas edhe një herë!
- Mos shkruaj përdërisa je duke kaluar rrugën!

Kujdesi juaj, siguri në trafik!

ECNI NË KËTË MËNYRË

Këto janë rregullat për siguri të këmbësorëve:

- Mos mbaj kufje gjatë kalimit të rrugës
- Kurrë mos kalo rrugën duke vrapuar
- Sigurohu që shoferi të ka vërejtur pa filluar kalimin e rrugës
- Qëndro i vëmendshëm gjatë kalimit të rrugës
- Gjatë natës përdor veshje me sinjal reflektues
- Shiko në të gjitha anët derisa kalon rrugën

AUTOMJETI MUND TË ZËVENDËSOHET, JETA NUK MUNDET!

Telefoni: 192

info@kosovopoliice.com
facebook.com/kosovopoliiceimp
www.kosovopoliice.com

Kritja e përdorimit të mjeteve kufizuese për fëmijët

Mjetet kufizuese për fëmijë janë shumë të efektshme në zvogëlimin e lëndimit dhe vdekjes së pasagjerëve fëmijë. Përdorimi i mjeteve kufizuese për fëmijë mund të çojë në të paktën 60% ulje të vdekjeve. Kriteret e praktikës më të mirë për ligjet e mjeteve kufizuese për fëmijë përfshijnë kërkesën për vendosjen e fëmijëve që kanë të paktën deri në dhjetë vjet ose 135 cm lartësi në mjet kufizues për fëmijë; kufizimin që fëmijët të ulen në ulësen e përparme dhe referencën për një standard të sigurisë për mjetet kufizuese për fëmijë.



Rritja e përdorimit të rripit të sigurimit

Vendosja e rripit të sigurimit zvogëlon rrezikun e vdekjes së shoferëve dhe pasagjerëve në ulësen e përparme prej 45-50% dhe rrezikun e vdekjes dhe lëndimeve serioze të pasagjerëve të ulëseve të pasme prej 25%. Kërkesa që të dy pasagjerët në ulëset e përparme dhe të pasme të përdorin rripa të sigurimit është kriter kryesor për praktikën më të mirë.



Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministère des Infrastructures et du Transport
Ministry of Infrastructure and Transport



Policia e Kosovës
Kosovo Police

10

Rregullat e arta të Sigurisë Rrugore

1. Kujdesuni që automejtit tuaj të jenë në gjendje të mirë teknike.
Automejti është material hartues, jeta bëritë e shpirtit, jetoje jetën!



2. Respekto ligjet dhe rregullat e sigurisë në trafik.
Rregullat shërbejnë për t'i respektuar detygim ligjor!



3. Shpejtësia vret, respektoni kufizimet e shpejtësisë!
Kontrollo shpejtësinë, mos lejo që shpejtësia të marrë jetën e tuaj dhe të dashurave tuaj.

50
Km/h

4. Vendose rripin, për sigurinë tuaj.
Në automejtin për udhëtarë dhe në mjedin transportues shoferi dhe të gjithë personat të cilët gjenden në njëjtë duhet t'i përdorin rripat e sigurisë, siç e parashihet prodhuesi i aij automejtit.



5. STOP drejtimit të automejtit nën ndikimin e alkoolit dhe drogës!
Alkoholi dhe Droga ndikojnë negativisht në aftësitë psikofizike të ngushtit dhe në aftësitë e drejtimit të mjedtit!



6. Kujdesu për fëmijët tuaj, edhe ata dëshirojnë të jetojnë më 80 vite!
Fëmijët nën moshën dyvjeçare (1,2) vjeç dhe me lartësi nën njëqind e pesëdhjetë (150) cm të cilët transportohen në mjedin tuaj duhet të jenë të siguarar tërësisht me sistem të sigurt, me ulëse të sigurisë për fëmijë, të përshtatur për moshën dhe lartësinë e fëmijës.



7. Përqendrohuni në udhëtim.
Shoferi të mjetit me veprim motorik gjatë kohës së drejtimit nuk t'lehet përdorimi i telefonit mobil!



8. Kur jeni i lodhur, pushoni!
Më mirë vonë se kurë, lodhja mund të shkaktojë rrezik për ju dhe pjesëmarrësit tjerë në trafik!



9. Vendose helmëtin.
Shoferi i cili drejton biçikletë, moped, motocikletë, triçikletë apo katërçikletë pa kabinë mbrojtëse, si dhe personat të cilët barten në këto mjete, duhet të mounë helmëta mbrojtëse përkatëse dhe gjithë qarkullimit në mjedin tuaj duhet t'i përdorin ato sipas udhëzimeve të prodhuesit të helmëtit.



10. Respektoni i rregullave është kulturë.
Me respektimin e rregullave kemi respektuar vetën, pjesëmarrësit tjerë në trafik, familjen tuaj dhe vendin.



Telefoni: 192

www.mit-ks.net
www.kosovopolice.com

Menaxhimi i shpejtësisë

Shpejtësia me të cilën udhëton një automjet ndikon drejtpërdrejt në rrezikun për përplasje, si dhe në ashpërsinë e lëndimeve dhe mundësinë për vdekje që vjen nga ajo përplasje. Menaxhimi efektiv i shpejtësisë është, si i tillë, thelbësor për shumicën e strategjive të ndërhyrjes së sigurisë rrugore.

Reduktimi i vozitjes nën ndikimin e alkoolit

Vlerësohet se 5-35% e të gjitha vdekjeve në rrugë raportohen si të lidhura me alkoolin. Vozitja pas pirjes së alkoolit rrit ndjeshëm rrezikun për përplasje dhe ashpërsinë e asaj përplasjeje.

Rritja e përdorimit të helmetës në motoçikletë

Lëndimet në kokë janë shkak kryesor i vdekjes dhe traumave të mëdha për përdoruesit e automjeteve me dy dhe tre rrota. Përdorimi i saktë i helmetës mund të çojë në ulje prej 42% të rrezikut të lëndimeve fatale dhe në ulje prej 69% të rrezikut të lëndimeve të kokës. Përdorimi i helmetave, si i tillë, është mjet gjithnjë e më i rëndësishëm për parandalimin e vdekjeve në trafikun rrugor. Praktika më e mirë për ligjet e helmetave në motoçikletë përfshin kërkesën që shoferët dhe pasagjerët të vendosin një helmetë në të gjitha rrugët, specifikimin që helmetat duhet të mbërthehen, dhe referencën për një standard helmete.

KËSHILLA KRYESORE SI TË PËRGATITEMI PËR NGASJE GJATË DIMRIT!

JINI TË VËMENDSHËM!

JINI TË VËMENDSHËM!

Asnjëherë nuk mund ta dimë se ku do të hasim në mot të lig apo rrugë të bllokuara! Në qoftë se jeni në automjet apo në ndonjë mjet tjetër, siguria fillon dhe mbaron me juve. Shikoni këshillat tona për ngasje të sigurt gjatë dimrit.

MOS NGITNI MJETIN TUAJ NËSE NUK ËSHTË ABSOLUTISHT E NEVOJSHME!

Udhëtimet në distanca të gjata janë veçanërisht të rrezikshme në një stuhë dëbore!

KUPTO JENI, UDHËTIMI ZGJAT MË SHUMË NË MOT TË LIG!

Të gjitha dritaret dhe pasqyrat duhet të jenë plotësisht të pastruara për të përmirësuar dukshmërinë, por mos harroni të pastroni kapakun mbi motor, kulmin dhe kapakun tek bagazhi.

PNEUMATIKËT

Pneumatikët e dimrit janë të shënuar me shenjë M+S, MS, M&S, ose ndonjë shenjë tjetër identifikuese nga prodhuesi i pneumatikëve.

MBANI NDEZUR DRITAT E AUTOMJETIT GJATË RESHJEVE!

Ju duhet të shihni mirë për ngasje të sigurt. Aktivizoni pastruesit e xhamave, mbani ndezur dritat tuaja, kjo ju mundëson të shihni më mirë dhe të jeni më të dukshëm për të tjerët gjatë reshjeve atmosferike. Mos harroni, dritat me rreze të ulëta, shpesh e bëjnë më të lehtë për t'u parë në dëborë të rëndë ose me erë.

ASNJËHERË MOS E KALONI NJË MJET/MAKINERI QË ËSHTË DUKE PASTRUAR RRUGËN NGA BORA

Operatori i pajisjeve nuk mund t'ju shohë dhe dukshmëria juaj është e kufizuar për shkak të reshjeve të dëborës, mbani distancë për sigurinë tuaj.

KONTAKTO POLIGINË E KOSOVËS
192
info@kosovopolice.com
www.kosovopolice.com
<https://www.facebook.com/KosovoPolice>



POLICIA E KOSOVËS
POLICIJA KOSOVA
KOSOVO POLICE



KËSHILLA KRYESORE SI TË PËRGATITEMI PËR NGASJE GJATË DIMRIT!











Kujdesi pas aksidenteve rrugore

Kujdesi urgjent është në thelb të reagimit pas aksidentit. Ekzistojnë një seri veprimesh të ndjeshme në kohë, të cilat janë thelbësore për të ofruar kujdes efektiv për të lënduarit, duke filluar me aktivizimin e sistemit të kujdesit urgjent dhe duke vazhduar me kujdesin në vendin e ngjarjes, transportin dhe kujdesin urgjent të bazuar në spital.

Automjetet e sigurta

Siguria e automjeteve është gjithnjë e më e rëndësishme për parandalimin e përplasjeve dhe është treguar se kontribuon në ulje të konsiderueshme të numrit të vdekjeve dhe lëndimeve serioze që vijnë nga përplasjet në trafikun rrugor. Karakteristikat e tilla si kontrolli elektronik i stabilitetit dhe frenimi paraprak janë shembuj të standardeve të sigurisë së automjeteve që mund të parandalojnë që të ndodhë një përplasje ose të zvogëlojnë ashpërsinë e lëndimeve.

Kontrolloni mjetin tuaj dhe sigurohuni se është në nivel të shërbimit, gjatë kohës me dëborë!

LLOJI I GOMAVE DHE PRESIONI I TYRE

Sigurohuni që gomat tuaja të jenë të parapara për ngasje gjatë dimrit, gjithashtu presioni i ajrit të tyre duhet të jetë sipas rekomandimeve të prodhuesit, gjatë kohës së ftohët.

15 nëntor - 15 mars

Kontrolloni rripin e alternatorit (prodhuesit të energjisë)

Mjeteve iu duhet më shumë energji gjatë kohës së ftohët.

SISTEMI I MBUSHJES SË BATERISË DUKE I PËRFSHIRË EDHE KABLOT

Bateritë zakonisht zgjasin tri deri në pesë vjet dhe dështimet janë më të zakonshme në dimër për shkak të rritjes së ngarkesave elektrike të fillimit të ftohjes. Nëse bateria juaj është më e vjetër se tri vjet, këshilloheni ta testoni nga një profesionist.

PASTRIMI I XHAMAVE

Vendosni fshirësit e xhamave të cilët rekomandohet të përdoren gjatë kohës me temperaturë të ftohët. Lëngu për pastrimin/fshirjen e xhamave kundër ngrirjes.

DRITAT, DUKE U SIGURUAR SE JANË EDHE REZERVAT

Inspektoni të gjitha dritat dhe zëvendësoni çdo llambë të djegur. Lehtësoni mënyrën e ngasjes, me shikueshmëri dhe nivelin e sigurisë.

VAJI I MOTORIT (LUBRIFIKANTËT)

Ndërroni/ndryshoni vajin në makinën tuaj, mbushni motorin tuaj me një vaj me viskozitet më të ulët.

Numri para W paraqet viskozitet, kështu që 5w-30 ka një viskozitet më të ulët se 10w-40

LËNGJET NË SISTEMIN E FTOHJES

Lëngjet në sistemin e ftohjes kundër ngrirjes. Kontrolloni dhe mbushni ftohësin, sigurohuni që ftohësi juaj të jetë mbushur, kontrolloni radiatorin për rrjedhje. Shumë mekanikë rekomandojnë të përdorni një përzierje 50/50 të lëngut kundër ngrirjes dhe ujit në radiator.

ÇANTA RRUGORE EMERGJENTE/ NDIHMA E PARË

Gjatë udhëtimit me të gjata apo malore, paktoni disa pajisje të rëndësishme, një çantë e mirë për mbijetesë ka të paktën një batanije, një çantë të ndihmës së parë, jelek reflektues, një brisk, dritë/bateri dore, bluzë/xhemper, litar, lopatë, e gjithashtu mbari një sprej kundër ngrirjes.

Në rast të ngecjes në rrugë përdor jelek reflektues, trekëndëshin e sigurisë dhe largoni mjetin tuaj sa më larg nga shiriti qarkullues.

Kontrolloni filtrat (ajrin, vajin dhe lëndën djegëse)

Zëvendësojeni ata nëse janë të nevojshëm.

HIQNI TËRËSISHT BORËN DHE AKULLIN NGA AUTOMJETI JUAJ!

Të gjitha dritaret dhe pasqyrat duhet të jenë plotësisht të pastruara për të përmirësuar dukshmërinë, por mos harroni të pastroni kapakun mbi motor, kulmin dhe kapakun tek bagazhi.

PËRFUNDIM

Siguria e trafikut rrugor është një sfidë mjaft e madhe me të cilën po ballafaqohen pothuajse të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.

Kosova në këtë aspekt, renditet në një vend mesatar sa i përket numrit të aksidenteve krahasuar me infrastrukturën rrugore, numrin e mjeteve dhe me numrin e popullsisë. Mortaliteti dhe lëndimet të cilat janë rezultat i aksidenteve në trafikun rrugor janë shumë serioze duke pasur parasysh edhe shtimin e vazhdueshëm të numrit të automjeteve në përdorim në Kosovë. Për të investuar në rritjen e sigurisë rrugore në vendin tonë,

shoqëria duhet gjithnjë të ketë pjesëmarrje aktive dhe është përgjegjësi e të gjithë akterëve relevant në përmbushjen e obligimeve.

Mesatarja e fataliteteve të shkaktuara, për 1 milion banorë si pasojë e aksidenteve gjatë vitit 2018 për të gjitha vendet e BE-së marrë bashkërisht ka qenë 49, ndërsa në Kosovë ky numër ka shkuar në 74.

Sipas statistikave të **numrit të përgjithshëm** të aksidenteve në trafikun rrugor për periudhën 2010 - 2019 në Kosovë, përqindja më e lartë e aksidenteve është si në vijim:

- 56 % e aksidenteve të trafikut rrugor kanë ndodhur në qytet.
- 16 % e aksidenteve të trafikut rrugor kanë ndodhur gjatë ditës së hënë.
- 31 % e aksidenteve të trafikut rrugor kanë ndodhur në intervalin kohor prej orës 14:00 - 18:00.

Sipas statistikave të numrit të **aksidenteve fatale** në trafikun rrugor, për periudhën 2010 - 2019 përqindja më e lartë e aksidenteve është në rajonin e **Prishtinës** me **30%** në nivel vendi.

Punuar me datë 29.05.2020